

VENDIM
Nr.6, datë 24.3.2009

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR SHAUK, POGRADEC

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodikës “Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik”, në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU- së

VENDOSI:

1. T’i miratojë SHAUK Pogradec:

a) tarifat e ujit për konsum publik si më poshtë:

	Për ujin e pijshëm	Për ujërat e ndotura
Konsumator familjar	52 lekë/m ³	13 lekë/m ³ ;
Institucione buxhetore	110 lekë/m ³	16 lekë/m ³ ;
Ente private	110 lekë/m ³	16 lekë/m ³ .

b) Tarifën fikse të shërbimit për furnizimin me ujë: 40 lekë në muaj për konsumator.

2. Ky vendim hyn në fuqi më 1.4.2009 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi